

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

SOKOL TONA - G J Y Q T A R

Asistuar nga sekretare gjyqësore Znj.Dasantila BEJKO, me pjesëmarrjen e prokuror Z.Dritan Rreshka, sot në datën 11 Dhjetor 2017, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çeshtjen penale me nr. 3017 Akti që i përket:

E PANDEHUR: V. P.identifikuar me pasaporte me nr. BC.5...2, e bija e Z. dhe e M. e dtl.03.09.19.. lindur dhe banuese ne Tirane Rr “...” nd 12 h.15 ap.20, arsim i larte, e padenuar, e ve, pensioniste, me shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga avokat Z. Erald Gaspri me nr.4466 Liçense dhe Nipt L 62030307 U i Dhomes se Avokatise Lezhe.

AKUZUAR: Per vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarisë kriminale”.

Baza Ligjore: Parashikuar nga Neni 287/1 i Kodit Penal.

Gjykata si çeli dhe zhvilloi seancat gjyqësore;

Si dëgjoi prokurorin i cili ne perfundim kerkoj:

-Deklarimin fajtores te te pandehures V. P.per vepren penale te “Pastrim te produkteve te vepres penale ose aktivitetit kriminal” te parashikuar nga Neni 287/1/a/b/ç i Kodit Penal dhe denimin e saj me 5 (pese) vjet burgim.

-Aplikimin e Nenit 59 te Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim me kusht per 3 (tre) vjet.

Prova materiale te sekuestruara:

-Parate e bllokuara ne shumen prej 18.300 dollar ne baze te Nenit 36 te Kodit Penal te konfiskohen.

-Shpenzimet paraprake ne ngarkim te te pandehures.

Si degjoj avokatin e te pandehures i cili ne perfundim kerkoj:

-Pafajesi per vepren per te cilen akuzohet;

Si degjoj te pandehuren e cila ne perfundim kerkoj:

-Jam dakort me avokatin, kërkoj pafajesi.

Si shqyrtoi dhe administroi provat ne teresi:

V Ë R E N

Ne kete Gjykate, Organi i Prokurorise ka sjelle per gjykim te pandehurën V. P.e akuzuar per kryerjen e vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga Neni 287/1 i Kodit Penal.

Organi i akuzes, duke pretenduar ne fajesine e te pandehures ne lidhje me kryerjen prej saj te vepres penale si me siper si edhe duke kerkuar administrimin e provave dhe denimin e saj, i parashtroj kesaj gjykate sa vijon:

E pandehura V. P. eshte banore e qytetit te Tiranës dhe aktualisht pensioniste.

Rezulton nga aktet se e pandehura V. P. gjate vitit 2015 ka perfituar dy transfertat me date 06.10.2015 ne shumën 3,800 Euro dhe me date 29.12.2015 shumën 1,600 Euro me urdhërues respektivisht shtetasin S. S. S. në Liban dhe nga një shoqëri e quajtur “C... R... LLC” në SHBA, të cilat i ka tërhequr fizikisht / cash ne datat 06.10.2015 dhe 07.01.2016.

Nga verifikimet në shoqërinë e transfertave Ak-Invest në lidhje me te pandehuren V. P. rezulton se gjatë periudhës Janar 2012 - Shkurt 2016 ajo ka urdhëruar 39 transfertat drejt destinacioneve të ndryshme si Anglia, Bregu i Fildishtë, Australi dhe Ganë. Ne date 13.10.2016 ka mbërritur ne favor te kësaj shtetase nje transfertë ne shumën prej 18.300 USD me pale urdhëruese një shoqëri në Kinë e quajtur “Sh... L...”.

Ne vijim te parashtrimit te faktit penal objekt akuze, organi i akuzës solli ne vëmendje te gjykatës edhe sa vijon:

Keshtu, pranë subjektit “Alpha Bank” ka mbërritur një e-mail i dërguar nga një subjekt i quajtur “R... S...”, i cili njofton se ka marrë disa e-maile nga shtetasi A. P., i cili është prezantuar si përfaqësues i shoqërisë së veshjeve “V...” dhe kërkon që t’i transferohen fondet në bazë të marrëveshjes që ka me kompaninë “V...” në llogarinë me nr AL18...80, llogari e cila rezulton te zoterohet nga e pandehura V. P..

Nga kqyrja e faqes zyrtare të QKR-se nuk rezultojnë biznese të regjistruara në emër të te pandehures V. Z. P. dhe transaksionet e kryera apo te tentuara per t’u kryer nga nje kompani e huaj ne emer te saj jane fiktive dhe me qellim transferimin e shumave te parave ne llogarine personale te kesaj te fundit per t’u perdorur me pas per transferime te tjera ne emer te personave te ndryshëm.

Nga aktet rezulton se e pandehura V. P. eshte e datelindjes 19.. dhe prej vitit 2007 eshte pensioniste.

Mbi konstatimin e faktit penal te mesiperm, si edhe kryerjen e veprimeve hetimore dhe procedurale organi i akuzes ka filluar çeshtjen penale ne ngarkim te te pandehurës V. P., duke e akuzuar ate per kryerjen e vepres penale sic pershkruhet ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Nga ana e saj e pandehura, si edhe nëpërmjet mbrojtjes se saj ne kete gjykim, duke mos pranuar akuzën dhe duke kërkuar deklarimin e saj te pafajshëm midis te tjerave ajo solli ne vëmendje te gjykatës faktin sipas te cilit me subjektet qe i dergonin para ishte njohur nepermjet internetit dhe lidhur me shoqerine “A... Group L.L.C” nuk kishte degjuar asnjehere per nje shoqeri te tille, ne lidhje me sa siper e pandehura ka pohuar se parate e derguara nga shoqeria “A... Group L.L.C” ishin derguar ne emer te saj per fillimin e nje biznesi tregtar. Duke vazhduar me pohimin rreth natyrës bamirëse te te pandehurës dhe duke motivuar dërgesat prej saj subjekteve te panjohur ne funksion te qëllimit te sipercituar, mbrojtja e te pandehurës i kërkoj kësaj gjykate deklarimin e saj te pafajshme, pasi ne veprimet e saj nuk ekzistojnë elemente te veprës penale, per te cilën ajo akuzohet.

Por ndonese pretendon sa sipër mbrojtja e te pandehures nuk i paraqiti kësaj gjykate asnjë prove ne funksion te nje qëndrimi te tille.

Me provat qe u shqyrtuan ne kete gjykim, gjykata sjell bindjen se organi i akuzës ka vlerësuar drejt si kualifikimin juridik te veprës penale ashtu edhe fajësinë e te pandehurës V. P. dhe per pasojë ajo duhet te ndëshkohet penalisht.

Ne nje konkluzion te tille gjykata arrin duke konsideruar sa vijon:

Keshtu ne drejtim te provueshmërisë se faktit penal objekt akuze kjo gjykate administroi dhe u njoh me prova shkresore te tilla si;

-Shkresa nr. ..., date 19.10.2016 te Drejtorise se Policise se Qarkut Tirane;

-Shkrese ZVRPP-se Tirane me nr. ..., date 11.03.2016;

-Shkrese e Njesise Bashkiake nr. 2, kthim pergjigje me nr. ..., date 24;

-Praktika procedurale e vendosjes se sekuestros preventive nga ana e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr. 1331 Akti, date 24.10.2016;

-Dokumentacion i administruar nga "Alpha Bank", sh.a me shkresen nr. ... prot., date 14.07.2017 mbi numrat e llogarive dhe gjendjen e tyre ne emer te te pandehures V. P.;

-Dokumentacion dhe prova shkresore te administruara nga institucioni financiar "A... I..." me shkresen nr. ... Prot., date 18.07.2017;

-Procesverbal qyryje i te dhenave nga sistemi kompjuterik TIMS per te pandehuren V. P.date 12.07.2017;

-Rregjistrime te bisedave telefonike per numrin 068...02 se bashku me procesverbalin e transkriptimit te komunikimeve date 02.12.2016;

Pervec provueshmërisë se faktit penal, gjykata gjen te drejte dhe nje argumentim te motivuar juridikisht edhe qendrimin e organit te akuzës ne lidhje me kualifikimin ligjor te veprës penale te parashikuar nga Neni 287/1 i Kodit Penal -Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarisë kriminale-

Kjo jo vetëm per konstatimin e ekzistencës se elementeve perberes te figures vepres penale te mësipërme, si ata qe lidhen me objektin dhe anen objektive te vepres penale apo edhe ata qe lidhen me subjektin dhe anen subjektive te saj, por edhe per rrethanat dhe faktet qe i behen prezentë kësaj gjykate te tilla si:

Transfertat e përfituara nga e pandehura V. P.me urdhërues shoqëri imobiliare nga Libani, me të cilat nuk rezultojnë kontrata noteriale të raportuara apo marrëdhënie biznesi; apo fluksi i transfertave të transferuara nga ana e saj drejt shtetasve të ndryshëm ne vende te ndryshme te botes pa ndonje lidhje mes tyre në vlera te ndryshme nepermjet shoqërisë së transfertave "A...-I..."; shfrytëzimi i llogarisë bankare të te pandehures nga shtetas të huaj për pagesen e vleres se nje malli te porositur si edhe transferta në mbërritje nga një shoqëri kineze me përfitues te pandehuren V. P.jo si individ, por me të dhëna të tjera bashkëlidhur "V. P.A... Group L.L.C" ndërkohë që nga faqja zyrtare e QKR-se nuk rezulton asnje biznes i rregjistruar ne emer te saj.

Siç konstatohet Shoqeria "A... Group L.L.C" me qender ne Dubai ka perzgjedhur si partner te saj per te kryer biznes ne Shqiperi te pandehuren V. P., duke transferuar ne llogarine personale te saj shumen prej 18.300 USD e cila eshte jo vetëm pensioniste dhe nuk ka asnje lidhje apo kontakt me shoqerine ne fjale, apo edhe qe sipas sistemit TIMS e pandehura nuk ka dale jashtë shtetit qe nga viti 2008, por edhe me pershkrimin e kryerjes se biznesit ne te ardhmen, ndonese pa asnje lloj marreveshje apo kontrate biznesi.

Pikerisht ne sa siper gjykata identifikon ne veprimet e te pandehurës elemente te veprës penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" duke konsideruar nga përmbajtja e saj faktin se perben pastrim te produkteve te vepres penale ose aktivitetit kriminal transferimi i pasurise se cdo lloji perfshire edhe parane me qellim fshehjen ose mbulimin e origjines se paligjshme si edhe disponimit dhe zhvendosjes se saj.

Ne analize te fakteve te tilla si:

-E pandehura V. P.pa patur asnje njohje dhe pa u takuar ndonjehere me personat qe i kane derguar ne menyre te vazhdueshme shuma te ndryshme parash;
-pa qene pjese e shoqerive apo pa patur lidhje biznesi duke qene se eshte pensioniste dhe nuk kryen asnje aktivitet privat me natyre tregtare fitimprurëse;
-pa udhetuar jashte shtetit qe prej viti 2008 ne keto vende nga ku i vijne shume parash te ndryshme nga individe dhe shoqëri, ajo ka perfituar shuma parash ne llogarite e saj bankare ne Euro dhe USD, duke urdhëruar me pas transferta te shumta ne destinacione ose shtete te tilla si Bregu i Fildishte, Gane, Australi etj, ne emer te individeve me te cilet e pandehura nuk ka asnje njohje, pikërisht prezenca e fakteve dhe rrethanave te mësipërme i sjellin bindje gjykatës ne dienine dhe qëllimin kriminal te te pandehurës se me veprimet e saj, ajo kryen veprën penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarisë kriminale” Neni 287 i Kodit Penal, ne paragrafin e fundit te se cilit, Ligjvenesit ne menyre te shprehur përcakton se “..Dijenja dhe qellimi sipas paragrafit te pare te ketij neni nxirren nga rrethana fakti objektive..”.

Ne lidhje me caktimin e llojit dhe te mases se denimit, gjykata vlereson rrezikshmerine shoqerore te vepres penale te kryer nga e pandehura, raportet shoqerore qe ajo cenon te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni yne penal dhe qe kane te bejne me garantimin e rendit dhe te sigurise publike.

Po keshtu, gjykata vlereson edhe rrezikshmerine e te pandehures, shprehur kjo veçanërisht ne faktin e kryerjes prej saj te nje vepre penale me dashje te drejtperdrejte.

Ne kete gjykim, gjykata vecon edhe disa rrethana lehtesuese te cilet i vlereson te tilla, ne kuptim te kriterëve te vendosura ne Ligjvenesit ne Nenit 48 dhe 49 te Kodit Penal.

Keshtu, gjykata çmon areyet ekonomike familjare dhe sociale te te pandehurës, veçanërisht moshën e saj si edhe faktin qe siç figuron nga aktet e pandehura V. P.rezulton pa precedent penal te mepareshem.

Per arsyet e mesiperme, gjykata gjen te drejte pretendimin e perfaqesuesit te organit te akuzes, ne lidhje me caktimin e nje denimi ne zbatim te Nenit 59 te Kodit Penal, duke pezulluar denimin me burgim ndaj saj si edhe duke e vene ne prove te pandehuren siç do te percaktohet ne dispozitivin e ketij vendimi.

Ne kete gjykim, gjykata bazuar ne Nenin 190 te Kodit te Proçedures Penale dhe 36 te Kodit Penal duhet te disponoje edhe mbi konfiskimin e shumes prej 18.300 USD ne llogarine me nr. 90...58 prane Bankes “Alpha Bank” Sh.a, Tirane ne emer te te pandehures V. P.duke urdheruar kalimin e kesaj shume ne favor te shtetit.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te Neneve 384, 390 dhe 190 te Kodit Proçedures Penale:

VENDOSI

-Deklarimin fajtores të të pandehures V. Y. P. per kryerjen e vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale” dhe ne baze te Nenit 287/1/a/b/ç te Kodit Penal e denon ate me 5 (pese) vjet burgim.

-Ne zbatim te Nenit 59 te Kodit Penal (te ndryshuar me Ligjin 36/2017 dt. 30.03.2017), Gjykata urdheron pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim, duke e vene ne prove te pandehuren per nje periudhe kohe prej 3(tre) vjetesh, me kusht qe ajo te mbaje kontakte me

Zyren Vendore te Sherbimit te Proves Tirane dhe brenda kesaj periudhe te mos kryej veper tjetere penale, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se ketij vendimi.

-Bazuar ne Nenin 36 te Kodit Penal shuma prej 18.300 (tetembedhjete mije e treqind) USD vendosur nen sekuestron preventive sipas vendimit nr.1331 Akti dt. 24.10.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ndodhur ne llogarine bankare me nr. 90...58 prane "Alpha Bank" Sh.a. Tirane, te konfiskohet dhe shuma e mesiperme te kaloj ne favor te shtetit. -Shpenzimet proçeduriale te kryera ne fazen e hetimeve paraprake si edhe ato gjyqesore i ngarkohen te pandehures.

-Kunder vendimit lejohet ankim sipas Ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall sot në Tiranë, më date 11 Dhjetor 2017.

SEKRETARE

GJYQTAR

Dasantila BEJKO

SOKOL TONA